

Vendim nr. 318 datë 26.12.2024

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë, i përbërë nga:

Holta Zaçaj	Kryetare
Genti Ibrahim, i	Anëtar
Sonila Bejtja,	Anëtare

në datën 26.12.2024 mori në shqyrtim paraprak kërkesën nr. 21 (M) 2024 të Regjistrimit Themeltar, që i përket:

KËRKUESE: MIRELA BERBERI

OBJEKTI: Shfuqizimi i vendimeve nr. (11-2011-3452)1682, datë 21.06.2011 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; nr. 10-2012-1972(924), datë 18.12.2012 i Gjykatës së Apelit Durrës; nr. 00-2015-4371, datë 22.12.2015 dhe nr. 00-2024-1339, datë 27.03.2024 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë.

BAZA LIGJORE: Nenet 33, 41, 42, 43, 131, pika 1, shkronja “f”, 134 pikat 1, shkronja “i”, dhe 2, si dhe 142, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (*Kushtetuta*); ligji nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar (*ligji nr. 8577/2000*).

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese (*Kolegji*), pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sonila Bejtja, shqyrtoi kërkesën, dokumentet shoqëruese, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I

Rrethanat e çështjes

1. Kërkuësja Mirela Berberi (pala e paditur në procesin gjyqësor) dhe vëllezërit e saj N.K. dhe R.K. (pala paditëse në procesin gjyqësor) janë bashkëpronarë të pasurive të paluajtshme apartament banimi me sipërfaqe 77.02 m², nr. pasurie 1/384+4-6, zona kadastrale 8514, dhe apartament banimi me sipërfaqe 49.66 m², nr. pasurie 3/209-1-2, zona kadastrale 8513, të ndodhura në qytetin e Durrësit, të fituara me trashëgimi. Shtetasit N.K. dhe R.K. i janë drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës me kërkesëpadi me objekt pjesëtimin e kësaj pasurie trashëgimore.

2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin e fazës së parë të pjesëtimit, ka lejuar pjesëtimin mbi këto pasuri të paluajtshme, duke njohur bashkëpronësinë e palëve ndërgjyqëse në pjesë të barabarta, 1/3 secili. Në fazën e dytë të pjesëtimit të pasurisë, për të përcaktuar pjesët e palëve dhe për ndarjen e tyre në natyrë, gjykata ka caktuar ekspert inxhinier vlerësues i pasurive të paluajtshme, i cili ka paraqitur tre variante për pjesëtimin e pasurisë.

3. Në përfundim të gjykimit, me vendimin nr. (11-2011-3452)1682, datë 21.06.2011, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur të pranojë kërkesëpadisë, duke pjesëtuar në natyrë pasurinë e përcaktuar me vendimin e fazës së parë të pjesëtimit në këtë mënyrë: paditësit N.K. dhe R.K. të marrin në bashkëpronësi, në pjesë të barabarta, apartamentin me sipërfaqe 49.66 m², ndërsa e paditura (kërkuësja) të marrë në pronësi apartamentin e banimit me sipërfaqe 77.02 m², duke u detyruar kjo e fundit që, për efekt kompensimi të pjesëve, t'i kthejë paditësve shumën 3,603,327 lekë (1,801,663 lekë secili) dhe për efekt të likuidimit të kësaj shume t'u paguajë paditësve shumën 25,000 lekë (12,500 lekë secili) në muaj, deri në likuidimin e saj. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim kërkuësja.

4. Gjykata e Apelit Durrës me vendimin nr. 10-2012-1972(924), datë 18.12.2012 ka vendosur lënien në fuqi të vendimit nr. (11-2011-3452)1682, datë 21.06.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës me ndryshimin e mosaktimit të afatit dhe të kësteve për ekzekutimin e detyrimit në të holla. Sipas gjykatës së apelit, në lidhje me pagesën në këste të detyrimit gjykata e shkallës së parë ka keqinterpretuar nenin 311 të Kodit të Procedurës Civile (KPC), pasi ky disponim mund të bëhet në fazën e ekzekutimit ose me pëlqimin e palës së interesuar, pëlqim të cilin ajo nuk e ka dhënë por edhe ankimuar. Kurse në lidhje me pretendimet e tjera të ngritura në ankim gjykata e apelit ka vlerësuar se janë të njëjta me ato të ngritura gjatë shqyrtimit gjyqësor në

shkallë të parë, të cilave u ka dhënë zgjidhje gjykata e faktit, duke arsyetuar se përse nuk duhen pranuar. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs kërkuesja.

5. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2015-4371, datë 22.12.2015, ka vendosur mospranimin e rekursit me arsyetimin se ai nuk përmbushte kriteret ligjore, pasi nuk përmbante asnjë shkak nga ato të përcaktuara në nenin 472 të KPC-së.

6. Ndërkohë, rezulton se shtetasi M.B. (bashkëshorti i kërkueses), ka paraqitur në gjykatë kërkesëpadi kundër kërkueses dhe shtetasve N.K. dhe R.K. (vëllezërit e saj), me objekt detyrimin e palëve të paditura ta njohin bashkëpronar në pasurinë e paluajtshme apartament banimi me sipërfaqe 77.02 m², të ndodhur në Durrës, me 1/6 pjesë të kësaj pasurie të paluajtshme.

7. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. (11-2016-2695)938, datë 13.06.2016, ka vendosur të pranojë pjesërisht kërkesëpadisë, duke detyruar të paditurën Mirela Berberi (kërkuesja) që ta njohë paditësin bashkëpronar të pasurisë apartament me sipërfaqe 77.02 m². Në lidhje me kërkimet e kërkesëpadisë ndaj të paditurve N.K. dhe R.K., gjykata ka vendosur rrëzimin e saj për shkak të mungesës së legjitimitetit pasiv të tyre. Ky vendim rezulton të ketë marrë formë të prerë më 18.07.2016.

8. Me kërkesën e datës 28.07.2016 kërkuesja i është drejtuar Gjykatës së Lartë me kërkesë për rishikimin e vendimeve: datë 24.03.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, të fazës së parë të pjesëtimit; nr. (11-2011-3452)1682, datë 21.06.2011 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës; nr. 10-2012-1972(924), datë 18.12.2012 të Gjykatës së Apelit Durrës; nr. 00-2015-4371, datë 22.12.2015 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë. Sipas kërkueses, vendimi nr. (11-2016-2695)938, datë 13.06.2016 i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, i cili ka njohur si bashkëpronar në pasurinë e paluajtshme apartament banimi me sipërfaqe 77.02 m² edhe bashkëshortin e saj, shtetasin M.B., përbën rrethanë të re sipas përcaktimeve të nenit 494, shkronja “a”, të KPC-së.

9. Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë, me vendimin nr. 00-2024-1339, datë 27.03.2024, ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikim, duke vlerësuar se nga dokumentacioni bashkëlidhur kërkesës dhe nga përmbajtja e saj nuk rezulton të jenë zbuluar rrethana të reja apo prova të reja me shkresë që kanë rëndësi për vendimin, të cilat nuk mund të dihen nga pala gjatë shqyrtimit të saj. Sipas tij, vendimi që pretendohet se përbën rast rishikimi nuk përmbush kriteret ligjore për t`u konsideruar rrethanë apo provë e re shkrese e zbuluar rishtazi dhe që nuk mund të dihej gjatë procesit gjyqësor të zhvilluar. Sipas Kolegjit Civil, nga përmbajtja e vendimeve objekt rishikimi rezulton që kërkuesja të jetë përfaqësuar në gjykimin e pjesëtimit të pasurisë nga bashkëshorti i saj, ndaj ky person ka qenë në dijeni të atij procesi gjyqësor dhe kishte mundësi të

ndërhynte në të ose të paraqiste, si përfaqësues i bashkëshortes, pretendimet e tij mbi të drejtat e bashkëpronësisë mbi pasurinë sipas bashkësisë ligjore, gjë që nuk e ka bërë. Kolegji Civil ka vlerësuar se kërkesja, më cilësinë e të paditurës në atë proces gjyqësor, ka ngritur edhe në rekurs pretendime për të drejtat e bashkëpronësisë së bashkëshortit të saj, të cilat janë konsideruar se nuk plotësojnë kushtet e pranueshmërisë sipas nenit 472 të KPC-së.

10. Në datën 31.10.2024 kërkesja i është drejtuar Gjykatës Kushtetuese (*Gjykata*), me ankim kushtetues individual, sipas objektit të tij, i cili, pasi është plotësuar sipas kërkesave të ligjit nr. 8577/2000, është regjistruar në datën 08.11.2024.

II

Pretendimet e kërkuases

11. **Kërkesja**, në mënyrë të përmbledhur, ka pretenduar se i është cenuar *e drejta për një proces të rregullt ligjor* në drejtim të:

11.1. *Së drejtës për t'u gjykuar nga një gjykatë e caktuar me ligj* në lidhje me të drejtën e aksesit dhe *asaj për t'u dëgjuar*, pasi Kolegji Civil e ka shqyrtuar kërkesën për rishikim në dhomën e këshillimit dhe në këtë mënyrë i ka mohuar kërkuases të drejtën për të marrë pjesë në mënyrë aktive në proces dhe me praninë fizike të saj. Kolegji Civil në vendimin e tij nuk ka arsyetuar në lidhje me arsyet për të cilat e ka shqyrtuar kërkesën për rishikim në dhomën e këshillimit.

11.2. *Standardit të arsytimit të vendimit*, pasi Gjykata e Lartë, si në vendimin nr. 00-2015-4371, datë 22.12.2015, ashtu edhe në vendimin nr. 00-2024-1339, datë 27.03.2024, nuk i ka dhënë përgjigje të arsyetuar pretendimeve me natyrë kushtetuese të ngritura nga kërkesja në rekurs dhe në kërkesën për rishikim. Kolegji Civil i ka bazuar arsyetimet e vendimit të vitit 2024 në ato të vitit 2015, kur nga kërkesja është pretenduar se numri i bashkëpronarëve në vendimin e Kolegjit Civil të vitit 2015 nuk ishte i njëjtë me numrin e bashkëpronarëve në vitin 2024, për rrjedhojë edhe pjesët takuese nuk janë të njëjta.

III

Vlerësimi i Kolegjit

A. *Për legjitimitimin e kërkuases*

12. Çështja e legjitimitetit (*locus standi*) është një ndër aspektet kryesore që lidhet me nisjen e një procesi kushtetues. Sipas neneve 131, pika 1, shkronja “f” dhe 134, pikat 1, shkronja “i” dhe 2, të Kushtetutës, si dhe nenit 71 të ligjit nr. 8577/2000, çdo individ, person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës private dhe publike, mund të vërë në lëvizje Gjykatën për gjykimin përfundimtar të ankesave kundër çdo akti të pushtetit publik ose vendimi gjyqësor që cenon të drejtat dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë. Ankimi kushtetues individual, në çdo rast, duhet të plotësojë kriteret kumulative të nenit 71/a të ligjit nr. 8577/2000, që lidhen me shterimin e mjeteve juridike efektive, afatin e paraqitjes së kërkesës, pasojat negative të pësuar në mënyrë të drejtpërdrejtë e reale, mundësinë për rivendosjen e së drejtës së shkelur, si dhe rregullimet e veçanta ligjore të shqyrtimit paraprak të kërkesës.

13. Në rastin konkret, Kolegji vëren se kërkesja legjitimohet *ratione personae*, në vështrim të shkronjës “f” të pikës 1 të nenit 131 dhe shkronjës “i” të pikës 1 të nenit 134 të Kushtetutës, pasi ka qenë palë në procesin gjyqësor objekt ankimi, për rrjedhojë justifikon interesin në çështjen e parashtruar.

14. Në lidhje me kriterin e *shterimit të mjeteve juridike efektive*, në kuptim të nenit 131, pika 1, shkronja “f”, të Kushtetutës, Kolegji vëren se kërkesja i është drejtuar Gjykatës me ankim kushtetues individual pas përfundimit të procesit gjyqësor në të tria shkallët e gjyqësorit të zakonshëm, për rrjedhojë ajo nuk ka mjet tjetër juridik në dispozicion për mbrojtjen e të drejtave të saj kushtetuese përveç paraqitjes së ankimit kushtetues individual.

15. Lidhur me legjitimitetin *ratione temporis*, neni 71/a, pika 1, shkronja “b”, i ligjit nr. 8577/2000, ka parashikuar afatin ligjor 4-mujor nga konstatimi i cenimit të së drejtës për paraqitjen e ankimit kushtetues individual. Në lidhje me llogaritjen e afatit për paraqitjen e ankimit kushtetues individual, Gjykata ka theksuar se kur ankimi ka të bëjë me një vendim të Gjykatës së Lartë, data e marrjes dijeni konsiderohet, data në të cilën vendimi i arsyetuar bëhet i disponueshëm për palët përmes depozitimit të tij në sekretarinë gjyqësore dhe publikimit në faqen zyrtare ose me njoftimin elektronik të tij, në rast se palët kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit (*shih vendimin nr. 42, datë 19.09.2023 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Kolegji vëren se kërkesja ka kundërshtuar në ankimin kushtetues individual si vendimet gjyqësore që janë dhënë në procesin gjyqësor të themelit për pjesëtimin e pasurisë së paluajtshme në bashkëpronësi, të cilat janë përmbyllur me vendimin nr. 00-2015-4371, datë 22.12.2015 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, ashtu edhe vendimin e Kolegjit Civil të Gjykatës

së Lartë për mospranimin e kërkesës së saj për rishikimin e vendimeve gjyqësore të formës së prerë.

17. Për sa i përket procesit gjyqësor të themelit, Kolegji vëren se pretendimet janë paraqitur nga kërkuësja përtej afatit ligjor për kundërshtimin e tyre, ndaj ato nuk mund të merren në shqyrtim, ndërkohë që paraqitja e një kërkesë për rishikimin e atyre vendimeve gjyqësore të formës së prerë nuk konsiderohet si një rivendosje në afatin ligjor për të paraqitur ankim kushtetues individual. Kolegji vëren se kërkuësja ka pasur të gjitha mundësitë dhe mjetet juridike në dispozicion për të kundërshtuar procesin gjyqësor të themelit në Gjykatën Kushtetuese, në përputhje me kriteret dhe afatet ligjore sipas legjislacionit në fuqi në atë kohë.

18. Për sa i përket vendimit tjetër të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, që ka vendosur mospranimin e kërkesës për rishikim, Kolegji konstaton se ai mban datën 27.03.2024, ndërsa ankimi kushtetues individual është paraqitur në Gjykatë në datën 31.10.2024. Për qëllime të këtij shqyrtimi është kërkuar informacion nga Gjykata e Lartë në lidhje me momentin në të cilin ky vendim është bërë i disponueshëm për palët. Sipas informacionit të datës 13.12.2024 të Gjykatës së Lartë rezulton se ky vendim është publikuar në faqen zyrtare të asaj gjykate në datën 18.06.2024, datë në të cilën është bërë i disponueshëm për palët. Kolegji vëren se në lidhje me përmbushjen e këtij kriteri ligjor, kërkuësja ka parashtruar vetëm se kërkesa e saj është paraqitur brenda afatit ligjor.

19. Kolegji, duke pasur parasysh standardet e vendosura në jurisprudencën kushtetuese në lidhje me momentin e marrjes dijeni të vendimit që përbën mjetin e fundit ankimor, vëren se vendimi i arsyetuar i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë është bërë i disponueshëm për palët në datën 18.06.2024, e cila përbën edhe datën e fillimit të afatit ligjor të ankimit kushtetues individual, ndërkohë që kërkesa është paraqitur në datën 31.10.2024, pra në tejkalim të afatit 4-mujor. Kërkuësja nuk ka paraqitur asnjë argument, pretendim ose provë se ka qenë në pamundësi për t'u informuar për gjendjen në të cilën ndodhej shqyrtimi i çështjes së saj në Gjykatën e Lartë apo për marrjen dijeni të vendimit të kundërshtuar. Ndërkohë, nga aktet bashkëlidhur kërkesës, nuk rezulton që kërkuësja të kenë lënë të dhënat elektronike të kontaktit me qëllim njoftimin e saj nga Gjykata e Lartë. Po kështu, duke qenë kërkuësja pala që ka vënë në lëvizje Gjykatën e Lartë me kërkesën për rishikim, ajo ka pasur, gjithashtu, detyrimin të ndjekë fatin e çështjes së saj. Kolegji çmon se për sa kohë që kërkuësja nuk ka arritur të provojë se ka marrë dijeni në një datë të ndryshme nga data në të cilën vendimi i Gjykatës së Lartë është bërë i disponueshëm për palët,

ankimi kushtetues individual konsiderohet se është paraqitur jashtë afatit 4-mujor të përcaktuar në nenin 71/a, pika 1, shkronja “b”, të ligjit nr. 8577/2000.

20. Në kushtet kur kriteri paraprak për legjitimimin *ratione temporis* nuk plotësohet, analiza e përmbushjes së kriterëve të tjera bëhet e panevojshme, për shkak të karakterit kumulativ të tyre.

21. Në përfundim, Kolegji vlerëson se ankimi kushtetues individual nuk plotëson kriteret ligjore për kalimin e tij për shqyrtim në seancë plenare.

PËR KËTO ARSYE,

Kolegji i Gjykatës Kushtetuese, në bazë të neneve 31 dhe 31/a, pika 2, shkronja “ç”, të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

V E N D O S I:

Moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare.